




Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 400/07-5047 dt. 29.01.2024

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/04, qershor 2008), të nenit 34, respektivisht neni 34.6 shkronjat a dhe c, por edhe neni 50 të Statutit të Komunës së Drenasit 01 nr.110-6904, i datës 24.09.2008, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 29.01.2024, miratoi këtë:

VENDIM

**PËR PËRCAKTIMIN E KOMPENZIMIT TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMUNAL
AKSIONAR PËR NDËRMARRJEN PUBLIKE LOKALE "PASTRIMI" SH.A**

I. TË MIRATOHET, Vendimi për përcaktimin e kompensimit RETROAKTIV nga data emërimit të anëtarëve të Komisionit Komunal Aksionar të Ndërmarrjes Publike Lokale "PASTRIMI" SH.A sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës për formonin e Komisionit Komunal Aksionar nr. 02/020/04-2401701 i dt; 30/05/2022

II. Anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve do të kompensohen, për çdo muaj sipas pagës minimale të përcaktuar të Ndërmarrjes Publike Lokale "PASTRIMI" SH.A ku edhe shërbejnë.

III. Mjetet financiare për kompensimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve do të merren nga Ndërmarrja Publike Lokale "PASTRIMI" SH.A ku edhe shërbejnë.

IV. Ky vendim do të do të ketë Vlefshmërinë vetëm për anëtarët e Komisionit Komunal Aksionarë të zgjedhur nga Kuvendi i Komunës, ndërsa kompensimin e Anëtarit në këtë Komision Komunal Aksionar të deleguar nga Kryetari i Komunës, këtij të fundit i rekomandohet këtë çështje ta rregulloj me Vendim të veçantë.

V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Ndërmarrja Publike Lokale "PASTRIMI" SH.A

VI. Vendimi hyn në fuqi për zbatim 7 ditë pasi të publikohet në Webfaqen e Komunës.

VII. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

- Vendimi i dërgohet:
- Zyrës së Kryetarit ;
 - Drejtorisë Përkatëse;
 - Zyrës së Kuvendit;
 - Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

[Signature]
Milaim Hajdari

ARSYETIM

Vendimi për përcaktimin e kompenzimit të anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve Ndërmarrja Publike Lokale "PASTRIMI" SH.A

Për shkak të përgjegjësive të mëdha ligjore që ngarkojnë mbi anëtarët e kuvendit të Komunës , që shërbejnë në Komisionin Komunal të Aksionarëve Ndërmarrja Publike Lokale "PASTRIMI" SH.A në pronësi të Komunës së Drenasit dhe duke marrur parasysh punën shitesë që këta persona janë të obliguar ta bëjnë në kuadër të këtyre përgjegjësive është vlerësuar edhe që të njëjtit të kompenzohen ashtu si është paraparë në dispozitiv të këtij PROPOZIM-VENDIMI